



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,  
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 202300829/1

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2023

**Lënda:** Rekomandime për inspektimin e bërë në Komisarlatin e Policisë Cërrrik.

**Drejtuar:** **Z. Ilir PRODA**  
Drejtori i Drejtorisë Vendore të Policisë

**ELBASAN**

**Z. Islam HAKA**  
Shefi i Komisarlatit të Policisë

**CËRRIK**

**Për dijeni:** **Z. Drejtues Madhor Muhamet RRUMBULLAKU**  
Drejtor i Përgjithshëm i Policisë të Shtetit

**TIRANË**

*Të nderuar zotërinj,*

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin e deritanishëm dhe duke vlerësuar angazhimin dhe punën e të gjithë stafit të institucionit që ju drejtoni, si dhe frymën e mirë të bashkëpunimit dhe mirëkuptimit midis institucioneve tona, në vijim po ju njohim mbi monitorimin që institucioni i Avokatit të Popullit kreu në Komisarlatin e Policisë Cërrrik.

Mekanizmi Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, seksion pranë Avokatit të Popullit, në vijim Mekanizmi Kombëtar (MKPT), bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar dhe nenin 81 të ligjit nr. 81/2020, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", kreu një inspektim në ambientet e privimit të lirisë të personit në Komisarlatin e Policisë Cërrrik.

Inspektimi u krye në datën 20.10.2023, sipas një Plani Vjetor Inspektimi të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin znj. Nertila Qafzezi, znj. Gloria Çarkaxhiu dhe znj. Lindita Dedegjoni me detyrë Nd/Komisionere pranë Mekanizmit Kombëtar.

Inspektimi kishte si qëllim verifikimin e respektimit të standardeve të përcaktuara në ligjin nr.108/2014, *“Për Policinë e Shtetit”*, i ndryshuar, procedurën standarde *“Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”*, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 925, datë 18.07.2019 si dhe procedurën standarde *“Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”*, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 938, datë 24.07.2019.

Institucioni i Avokatit të Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues ka detyrimin ligjor t’ju parashtojë konkluzionet përfundimtare, që do të keni më poshtë:

### **Shënime të përgjithshme**

Në përputhje me metodologjinë e zhvillimit të inspektimit në institucionet ku mbahen e trajtohen shtetas të privuar nga liria, grupi i punës u takua me Shefin e Komisarariatit të Policisë Cërrik z. Islam Haka, i cili u vu në dijeni lidhur me qëllimin e inspektimit.

Nga informacioni i marrë rezultoi se ky institucion në muajin Mars të Vitit 2016 është kthyer nga Postë Policie në një Komisarariat Policie.

Në vijim të takimit, Shefi Komisarariatit informoi grupin e inspektimit në lidhje me përmirësimin e kushteve të ambienteve të shoqërimit të këtij Komisaritati, sipas kritereve të përcaktuara në procedurat standarde.

Grupi i inspektimit, pasi mori informacionin e nevojshëm vijoi takimin me punonjësit e policisë që shërbenin në zyrën e informacionit dhe në dhomat e shoqërimit. Theksojmë se, drejtuesi i Komisarariatit dhe punonjësit e policisë u treguan bashkëpunues dhe transparentë gjatë komunikimit dhe inspektimit, që zhvilloi grupi inspektues në ambientet e këtij Komisaritati.

Në përfundim të inspektimit grupi monitorues konstatoi se, megjithëse në Komisariatin e Policisë Cërrik ishin marrë disa masa për përmirësimin e kushteve lidhur me të drejtat e personave të shoqëruar dhe të personave të arrestuar/ndaluar, vazhdonin të ishin të pranishme disa problematika si më poshtë vijon:

### **Ambienti i shoqërimit dhe kushtet e tyre,**

Në Komisariatin e Policisë Cërrik, ambienti i shoqërimit nuk ishte i ndërtuar përgjithësisht sipas parashikimeve të bëra në ligjin nr.108/2014 *“Për Policinë e Shtetit”*, i ndryshuar, si dhe në procedurën standarde *“Rregullat teknike të shoqërimit*

*në polici*”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938, datë 24.07.2019.

Mjedisi i shoqërimit përbëhej nga **1(një) dhomë shoqërimi** me përmasa 5x5 m, e cila përdorej për meshkujt madhorë, ndërkohë **që nuk kishte dhomë për shoqërimin e grave dhe të miturve.**

Ky ambient ndodhej në katin e parë të ndërtesës të këtij komisariati. Në hyrje të godinës ndodhej dhoma e shoqërimit me sipërfaqe dhe hapësirë të bollshme për qëndrim, ishte e pajisur me dritare e cila lejonte ajrimin dhe ndriçimin natyral, si dhe kishte ndriçim nga rrjeti elektrik.

Dhoma e shoqërimit ishte e pastër nga ana higjieno-sanitare, ishte e lyer dhe e pajisura me orënditë e nevojshme, si tavolinë dhe karrige për qëndrimin ulur të shtetasve të shoqëruar. Në korridorin e ambientit të shoqërimit ndodhej një tualet, i cili ishte i pastër dhe kishte çezmë me ujë të rrjedhshëm.

Në Komisarati e Policisë Cërrik, gjatë periudhës 01.01.2023 deri më 20.10.2023 ishin të shoqëruar, të ndaluar apo të arrestuar dhe të evidentuar në regjistrin e shoqërimit 180 persona të shoqëruar nga të cilët 8 gra dhe 4 të mitur. Në momentin e inspektimit, nuk kishte asnjë shtetas në dhomën e shoqërimit.

Ambienti i shoqërimit në këtë komisarati **nuk kishte sistem monitorimi me kamera** për mbajtjen në vëzhgim të korridorit dhe dhomës së shoqërimit.

Në ambientet e Komisarati e Policisë Cërrik ishin të vendosura posterat të cilat pasqyronin të drejtat e personave të shoqëruar.

Në kohën e kryerjes së inspektimit nuk kishte asnjë person të shoqëruar dhe për rrjedhojë grupi i inspektimit nuk mundi të realizoi intervista me këta persona, në lidhje me trajtimin që u bëhet në mjediset e policisë.

### **Ambientet e sigurisë dhe kushtet e tyre.**

Në Komisarati e Policisë nuk kishte ambiente të sigurisë. Personat e arrestuar/ndaluar pasi evidentoheshin në regjistrin përkatës, dërgoheshin menjëherë në dhomat e sigurisë të Komisarati të Policisë Elbasan.

### **Regjistri i personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar si dhe trajtimi i tyre,**

Gjatë inspektimit u konstatua se në Komisarati Cërrik, “Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar” ishte plotësuar në zbatim të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, sipas tipit “Model nr.1”, konform procedurave

standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin nr.938 datë 24.07.2019 e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe ishte i sekretuar.

Të gjithë personat e shoqëruar në organin e policisë sipas dispozitave të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit” regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit.

Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se:

Koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi të shtetasve ishte e ndryshme nga 1 deri në 10 orë në raste të veçanta. Rubrikat e regjistrit ishin plotësuar në mënyrë korrekte, me përgjegjësi dhe saktësi nga punonjësit e policisë.

Në këtë Komisariat kishte regjistër për personat e ndaluar/arrestuar, ku evidentoheshin të gjitha rastet e ndalimeve dhe arrestimeve të kryera nga punonjësit e këtij organi, i cili ishte i sekretuar. Nga verifikimi i këtij regjistri rezultoi se në rastet e arrestimeve dhe të ndalimeve të personave të shoqëruar, ora e arrestimit/ndalimit përputhej me orën e shoqërimit të tyre në organin e policisë.

Gjithashtu, përgjatë inspektimit konstatuam se personat e shoqëruar nga policia **nuk ju jepet informacioni për të drejtat e tyre në formë shkresore, që nga fillimi i privimit të lirisë, për të siguruar informim të qartë në lidhje me të drejtat ligjore/procedurale që ata kanë.** Mekanizmi Kombëtar për parandalimin e torturës sugjeron dhënien e kartës të drejtave që në momentin e hyrjes në Komisariat<sup>1</sup>. Rekomandimi i CPT-së, në përmbajtjen e tij nënkupton që karta me të drejtat që gëzojnë personat kur hyjnë në mjediset e policisë, **duhet tu jepet edhe personave që mbahen në dhomat e shoqërimit**, pra që në momentet e para të privimit të lirisë. Kjo, pasi këtyre personave ju kufizohet liria deri në 10 orë (maksimumi) qëndrimi në dhomat e shoqërimit, ata merren në pyetje nga specialistët e policisë apo kanë të drejtë për njoftimin e familjarëve të tyre, e drejta për qasje me avokat mbrojtës, etj. Aktualisht, karta me të drejtat jepet vetëm në momentin kur i ndaluar/arrestuari merret në pyetje nga OPGJ dhe hyn në dhomat e sigurisë.

Komisariati i policisë Cërrik **nuk ishte i pajisur me një regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar**, sikurse parashikohet në Nenin 115 të Ligjit Nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar.

## **Ambientet e intervistimit**

---

<sup>1</sup> Raporti i Komitetit Europian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin Çnjerëzor dhe Degradues (KPT), gjatë vizitës së tyre në Shqipëri në datat 20 - 30 Nëntor 2018.

Në Komisarlatin e Policisë Çërrik, oficerët e policisë gjyqësore i kryenin veprimet procedurale me të shoqëruarit në mjediset e policisë, në zyrat e punës së tyre, për shkak të mungesës të ambienteve të veçanta për marrjen në pyetje/intervistimin e shtetasve të shoqëruar. Këto zyra, nuk ishin të monitoruara me sistemin e kamerave.

Krijimi i zyrave të veçanta ku merren në pyetje shtetasit gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto zyra, është rekomandim i Avokati i Popullit referuar standardeve ndërkombëtare<sup>2</sup>, të cilat e konsiderojnë procesin e monitorimit filmik si një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve e arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e Policisë së Shtetit. Ky standard ka gjetur rregullim edhe në procedurën standarde të miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 925, datë 18.07.2019, “*Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre*”, duke u shndërruar në rregull të detyruar për punonjësit e policisë.

Nga monitorimi i zyrave të punonjësve të policisë, nuk u gjetën sende, prania e të cilave të ekspozonte dhunë tek personat me të cilët ata kryenin veprime procedurale.

### **Ndihma juridike dhe psikologjike**

Grupi i inspektimit, në mungesë të personave të shoqëruar, intervistoi punonjësit e policisë, ku rezultoi se në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit madhorë të cilët nuk kishin mundësi financiare për të pajtuar avokat privat dhe kërkonin ndihmë juridike, atyre iu sigurohej mbrojtja me avokat.

Në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin të mitur, veprimet procedurale kryheshin në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht, përfaqësuesit ligjor dhe të psikologut.

Ndërkohë u konstatua se në këtë Komisarlat zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në Nenin 109/5 dhe 122/5 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si

---

<sup>2</sup> “Një sistem i monitorimit të vazhdueshëm i standarteve dhe procedurave të intervistave të policisë duhet vënë në zbatim, po ashtu; kjo kërkon një regjistrim të saktë të intervistave të personave në ambientet e policisë, të cilat, nëse është e mundur duhet të zhvillohen me pajisje regjistruese elektronike (audio dhe/video). Duhet të kërkohej që të regjistrohet në mënyrë sistematike koha kur ka filluar dhe mbaruar intervista, ndonjë kërkesë të bërë nga i ndaluarit gjatë intervistës, si dhe të personave të pranishëm gjatë çdo interviste.” Raporti i CPT-së për Armeninë: CPT/Inf (2016) 31 [par.20].

Konsulto:

<https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=09000016806bf46f>

dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurave standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse<sup>3</sup>.

Për sa më sipër dhe me qëllim zgjidhjen e problemeve të konstatuara gjatë këtij inspektimi, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku parashikohet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike” dhe në bazë të nenit 21/b të ligjit nr. 8454 dt.04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”,

### **REKOMANDOJMË:**

1. Marrjen e masave të menjëhershme për ndërtimin e ambienteve të shoqërimit, sipas kushteve dhe kritereve të parashikuara në procedurat standarde miratuar me Urdhrin nr. 938, datë 24.07.2019, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, duke krijuar ambiente të përshtatshme, dinjitoze, të pajisura me orënditë e nevojshme për qëndrim, të ndara më vete duke respektuar standardet për gra, burra dhe të mitur.
2. Marrjen e masave të nevojshme për të krijuar dhomat e intervistimit në ambientin e shoqërimit dhe ndërprerjen e menjëhershme të praktikës së parregullt e tashmë të pajustificuar, për marrjen në pyetje të personave në zyrat e OPGJ-ve dhe pa monitorim.
3. Marrjen e masave të nevojshme, për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në korridorin e ambientit të shoqërimit dhe në dhomën për marrjen në pyetje/intervistimin e shtetasve të shoqëruar apo të arrestuar/ndaluar në mjediset e këtij komisariati.
4. Marrjen e masave të menjëhershme për pajisjen e këtij komisariati me një regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar, sikurse parashikohet në Nenin 115 të Ligjit Nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar.
5. Marrjen e masave të nevojshme për të siguruar që personat e ndaluar nga policia të jenë plotësisht të informuar për të drejtat e tyre që nga fillimi i heqjes së lirisë dhe të ndërpritet praktika e njohjes me të drejtat vetëm pasi merret në pyetje nga Oficerët e Policisë Gjyqësore.

---

<sup>3</sup> Ligji nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” i ndryshuar.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.*

**KOMISIONERI**

**Ahmet PRENCI**

Konc. & Dakord.:  
N. Qafzezi  
G. Çarkaxhiu  
L. Dedegjoni